


# NË DIMËR, DEMOKRACIA



NA NGROH ZEMRAT

## NE BESOJMË NË IDETË TUAJA

VALDRIN (14), AGNESA (15), FAHRIJE (14), EDON (14), ELMEDINA (15), MËRGIM (14)



**Ne si nxënës sot kemi vendosur të përshkruajmë rrugëtimin tonë drejt së ardhmes në demokraci. Se çfarë nënkuptojmë me këtë, lexojeni këtë artikull**

Secili qytetar pa marrë parasysh racën, fenë, gjininë e tij/saj duhet ta gëzojë të drejtën e votës. Kjo ndodh vetëm në demokraci. Populli është baza e një shteti. Ai bën që një shtet të funksionoj ashtu siç duhet. Por, si udhëheq populli? Populli udhëheq përmes zg-



**Kjo është mënyra se si ne vendosim për të ardhmen**

jedhjes së përfaqësuesve të tij. Partitë politike janë një grup qytetarësh me ide dhe interesa të përbashkëta. Këto grupe mundohen që në çdo aspekt t'i sjellin shtetit një të ardhme sa më të suksesshme. Çdo parti i përfaqëson idetë e veta dhe popullit i mbetet vetëm t'i vlerësojë ato. Populli, patjetër që don një të ardhme të ndritur. Në vazhdim, dëshirojmë të tregojmë një ngjarje që na ka ndodhur pak kohë më parë. Ishim disa shokë duke biseduar me njëri-tjetrin.


Njëri nga ne, filloi të flas për nevojat e vendit tonë. Të tjerët u bashkangjitën në këtë bisedë. Biseda vazhdoi duke diskutuar edhe për problemet e fshatit ku jetojmë. Gjersa flisnim, një shokut tjetër i lindi një ide për të formuar një parti politike. Ideja e tij na pëlqeu të gjithëve dhe ne vazhduam të imagjinonim se çfarë do të ndodhte nëse ne me të vërtetë do ta formonim një parti politike. Me vete thamë se ne si parti politike duhet ta kemi kryetarin, sekretarin, si dhe selinë e partisë. Neve gjithashtu na duhet të dalim para qytetarëve të Kosovës dhe të përpiqemi t'i bindim ata të na votojnë në zgjedhjet e ardhshme. Kështu ne do të mund të ndryshojmë për të mirë të ardhmen e vendit tonë. Projekti apo planprogrami i çdo partie duhet të formohet sipas nevojave të qytetarëve. Partitë politike nuk duhet të bëjnë dallime në mes të gjinisë, fesë, racës, etj. Çdo parti politike duhet të mbështetet nga qytetarët. Ato përfundimisht e përcaktojnë të ardhmen tonë.



**Ne premtojmë se do të jemi udhëheqës të mirë**

# NE I VOTOJMË, ATA PUNOJNË PËR NE

DOMINIK (15), VALMIRE (14), ERIJONA (14), GENC (14), FJOLLA (15)



## Zgjedhjet qendrore

Për t'i kuptuar më mirë zgjedhjet qendrore, po fillojmë me disa shembuj nga jeta jonë e përditshme, se çfarë do të thotë të zgjedhësh. Nëse ne shkojmë tek një auto sallon dhe shohim vetura të tipeve të ndryshme si: familjare, sportive, luksoze, etj., ne do ta zgjedhim veturën, e cila na përshtatet neve si individ. Atë makinë, pastaj, do ta përdornim për një kohë të caktuar. Edhe kur dëshirojmë të luajmë ndonjë lojë, ne kemi mundësi të zgjedhim atë lojë që na pëlqen. Kjo ndodh sepse në demokraci ne e kemi të drejtën për të zgjedhur dhe për të marrë vendime.

Po ashtu, edhe në zgjedhjet qendrore, populli merr vendime duke i votuar dhe zgjedhur përfaqësuesit e tij. Në zgjedhjet qendrore, populli i përzgjedh kandidatët për deputetë, për të cilët mendon se janë më të përshtatshëm. Pastaj, këta deputetë qëndrojnë në atë pozitë për 4 vjet dhe marrin vendime, të cilat ndikojnë në jetën e secilit. Prandaj, ne duhet të mendo hemi mirë për votat tona, sepse ato kanë një vlerë shumë të madhe, jo vetëm për kandidatin, por, edhe

për popullin. Për këtë arsye, ne duhet të kemi kujdes, sepse ai/a jo do të qëndroj për 4 vjet në atë post zyrtar dhe prej tij/saj mund të ndodhin ndryshime të mëdha, goftë në të mirë apo në të keq.

## Zgjedhjet lokale

Në kohën kur është shfaqur për herë të parë demokracia, të drejtën e votës e kishin vetëm burrat e pasur. Kurse, gratë dhe skllëverit nuk e gëzonin këtë të drejtë. Sof, për dallim nga ajo kohë, të gjithë pa dallim gjinie, feje, etj., e kemi të garantuar me ligj të drejtën e votës. Andaj, kur përmendet fjala demokraci, zakonisht në mendje na bie edhe barazia, sepse në demokraci të gjithë jemi të barabartë.

Sikurse në zgjedhjet qendrore, edhe në zgjedhjet lokale qytetarët votojnë përfaqësuesit e tyre. Mirëpo, për dallim nga ato qendrore, në këto zgjedhje votohet kryetari i komunës dhe asamblistët.

Me të drejtë e themi se ne jemi ata, të cilët vendosim për të ardhmen dhe fuqia e ndryshimit është pikërisht në duart tona.



Votoni edhe ju!




Grupi „Andromeda“



## QYTETARIA AKTIVE

PREMTON (14), ERIS (14), DUKAGJIN (15), SONILA (14), BLENDA (14), SARA (14)



### Më poshtë mund të mësoni disa nga mënyrat se si mund të jemi aktiv në shtetin tonë

Shumë shpesh gjatë orëve të mësimit, mësimdhënësit tanë kërkojnë nga ne të jemi aktiv. Kjo nënkupton që të jemi të interesuar rreth mësimit, të pyesim nëse kemi diçka që nuk kemi kuptuar, të përgjigjemi në pyetjet e mësimdhënësve, e kështu me radhë.

Mirëpo, ora e mësimit në klasë nuk është i vetmi vend ku ne mund të tregohemi aktiv.

Aktiv mund të tregohemi edhe në lagjen tonë, qytetin tonë apo edhe shtetin tonë. Për shembull, ne në fshatin tonë Prugoc, kemi nevojë të kemi më shumë ndriçim në rrugë, sidomos gjatë stinës së dimrit. Për ta zgjidhur këtë problem, ne kemi dy mënyra. E para është të shkojmë në Komunën tonë dhe ta paraqesim rastin si shqetësues për banorët. E dyta mundësi është që ne banorët e fshatit, të organizohemi dhe ta rregullojmë vetë ndriçimin. Që të dyja këto mundësi na bëjnë neve qytetarë aktiv. Nëse do ta injoroni problemin dhe të prisim që dikush tjetër ta zgjidhte atë për ne, atëherë nuk do të tregoheshim aktiv. Përkundrazi, ne do të tregoheshim qytetarë të painteresuar për vendin tonë. A është kjo gjë e mirë? Sigurisht se jo.

Vetë-iniciativat që qytetarët marrin për të rregulluar jetën në komunitet, njihen si qytetari aktive. Qytetarët aktiv nuk mendojnë vetëm për vete, por për të gjithë. Disa mënyra të tjera se si mund të jemi aktiv janë: të votojmë, të pastrojmë ambientin, të marrim pjesë në tubime publike, etj.

Qytetarët në demokraci kanë edhe shumë të drejta që i gëzojnë. Këto të drejta janë të barabarta për të gjithë, pa asnjë dallim. E drejta e shprehjes së lirë, e shkollimit, e votës, janë vetëm disa nga të drejtat që ne i gëzojmë në demokracinë tonë. Megjithatë, nuk duhet të harrojmë se me të drejtat, vijnë edhe përgjegjësitë. Ne si qytetarë pa dyshim se kemi përgjegjësi ndaj vendit tonë. Disa nga këto përgjegjësi janë: respektimi i ligjeve, pagesa e taksave, pjesëmarrja në zgjedhje, mbrojtja e ambientit, etj.

Demokracia ka një formulë të thjeshtë. Ajo të dhuron kaq shumë, mirëpo edhe ti duhet të punosh në forcimin e saj. Kjo mund të arrihet duke i praktikuar të gjitha ato që i cekëm më lart.

Ne ju ftojmë të vazhdoni leximin në faqen numër 5. Aty iu presin disa vizatime të punuara nga ne.



Gazetarët aktiv


**Të dashur lexues, bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm në demokraci. Prandaj, edhe ne kemi bashkëpunuar në shkrimin e kësaj gazete. Më poshtë mund të gjeni vizatimet e punuara nga grupi i „Qytetarisë aktive“ ndërsa artikulli është shkruar nga grupi „Ne besojmë në idetë tuaja“**

Në këtë pjesë do të vazhdojmë të flasim për demokracinë, pasi që kjo është shumë e rëndësishme për të gjithë qytetarët. Demokracia ka prejardhjen në Greqinë e vjetër. Emri demokraci ka rrjedhur pikërisht nga kjo gjuhë. Më saktë nga dy fjalë greke. E para është „demos“ që do të thotë popull dhe fjala e dytë „kratos“ që do të thotë udhëheqje. Në tërësi, kjo fjalë ka kuptimin e një udhëheqje nga populli.


E kundërta e demokracisë është autokracia. Kjo fjalë ka rrjedhur nga greqishtja e vjetër. „Auto“ do të thotë vetë ose një, ndërsa „kratos“ ashtu siç e lexuat më lart, do të thotë udhëheqje. Kjo formë e udhëheqjes neve nuk na pëlqeu aspak, sepse udhëheqja e vetëm një personi nuk i përmbush dot kërkesat e qytetarëve.

Demokracia si sistem i garantimit të lirive dhe sovranitetit është forma më e mirë e udhëheqjes që e njohim deri më sot. Ajo është përpjekje e vazhdueshme për drejtësi dhe tolerancë, pavarësisht dallimeve të qytetarëve.

Edhe në Kosovë qytetarët dallojnë në mes vete. Ata nuk flasin gjuhën e njëjtë, nuk besojnë në të njëjtën fe, nuk kanë të njëjtën ngjyrë të lëkurës, dhe nuk i përkasin të njëjtit etnicitet. Por, kjo nuk do të thotë asgjë, pasi që ata i gëzojnë të gjitha të drejtat. Çdo qytetar, i cili jeton në një vend ku mbizotëron demokracia ndihet i lirë. Demokracia është liri dhe përgjegjësi. Për vete dhe për të tjerët. Në mendim, në fjalë dhe në vepra. Para zgjedhjeve dhe pas tyre!




**Qytetarët aktiv marrin pjesë në procesin zgjedhor. Ata janë të vetëdijshëm për rëndësinë që ka vota dhe duan të jenë pjesë e vendimmarrjes në vendin e tyre**



**Vetëm duke punuar së bashku mund të arrijmë të ndryshojmë vendin tonë. Të jemi bashkëpunues në demokraci dhe të arrijmë suksesin e merituar**





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nexhmi Mustafa“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-3  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prugoc, Prishtinë